**L I G J**
**Nr.7944, datë 1.6.1995**

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7906, DATË 4.4.1995 "PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 1995"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7906, datë 4.4.1995, në nenin 5, në tabelën nr.1 “Buxheti i vitit 1995 sipas grupeve” bëhet ndryshimi si vijon:

“Grupi 29 me emërtimin “Gjykata e Kasacionit” hiqet dhe të gjitha fondet e parashikuara për këtë grup kalojnë në grupin me emërtimin “Sistemi gjyqësor” ku këto fonde detajohen për çdo zë sipas strukturës buxhetore dhe për çdo gjykatë”.

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si vijon: “Përjashtimisht për vitin 1995 ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda datës 10 qershor 1995, të paraqesë në Kuvendin Popullor për miratim ndarjen e detajuar të shpenzimeve të grupit me emërtimin “Sistemi gjyqësor” për institucionet përbërëse të sistemit gjyqësor.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet e tij shtrihen nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.7906, datë 4.4.1995 “Për buxhetin e shtetit për vitin 1995”.

**Shpallur me dekretin nr.1119, datë 7.6.1995 të Presidentit të Republikë së Shqipërisë, Sali Berisha**